



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA – REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI HISTORISË – INSTITUTE OF HISTORY – INSTITUT ZA ISTORIJU	
Nr. Org. Org. Unit Org. Jed.	Nr. Prot. Prot. N. Dr. Prot.
Nr. Faqeve No. Pages Br. Stranica	Data: Datum:
I. H	01/107/24
	26.12.2024
PRISHTINË – A	

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU “ALI HADRI” PRIŠTINA

Prishtinë, 26.12.2024

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:

Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 – 2008 - zgjedhje

Bazuar në konkursin e shpallur nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, të publikuar gazetën “Epoka e Re” e datës 28 nëntor 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurse/Konkurs-Instituti-i-Historise-28-11-2024.pdf>, duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve dhe rregulloreve e akteve të tjera përkatëse të Institutit, si dhe bazuar në vendimin e datës 27.11.2024 të Këshilli Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Komisioni recensues për vendin e punës Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 - zgjedhje, në përbërje prof. dr. Fehmi Rexhepi - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha – anëtare, dhe prof. dr. Teuta Shala - Peli anëtare, kemi nderin t’i paraqesim Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, këtë:

RECENSION

për kandidatin Arbër HADRI

Mbështetur në dokumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat është shpallur konkursi i cekur më sipër si dhe në dosjen e kandidatit të paraqitur, Komisioni recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 - zgjedhje*, ka konkurruar vetëm kandidati Arbër Hadri.

Komisioni recensues pas verifikimit të dokumentacionit relevant dhe mbështetës, të nevojshëm dhe të dëshmuar në CV përkatëse, konstatoi se kandidati Arbër Hadri i plotëson kushtet formale - juridike për t’iu nënshtruar procedurave të mëturjeshme të përzgjedhjes për

këtë vend pune, respektivisht për të vazhduar me shqyrtimin e të arriturave profesionale-akademike të kandidatit në përputhje me dispozitat dhe kushtet e cekura në preambulën e këtij konkursi.

Të dhëna biografike për kandidatin

Kandidati Arbër Hadri lindi më 9 mars 1974 në Prishtinë – Republika e Kosovës. Arsimin fillor dhe të mesëm e përfundoi në Pejë. Studimet themelore i përfundoi në Universitetin e Prishtinës me notën mesatare maksimale (10). Po ashtu, përfundoi studimet master në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në drejtimin Histori, duke arritur sukses shembullor (10).

Studimet e doktoratës i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në drejtimin Histori, me fokus në Historinë Bashkëkohore, në vitin 2018. Me sukses shembullor (10), ai mbrojti tezën e doktoratës me titull “Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës 1989–2008.”

Aktualisht, Arbër Hadri shërben si Sekretar Shkencor në Institutin e Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, ku bashkërendon veprimtarinë shkencore, profesionale dhe botuese të institutit. Njëkohësisht, ai vepron si punonjës shkencor, i specializuar në periudhën e historisë bashkëkohore shqiptare dhe asaj të Kosovës.

Krijimtaria shkencore e Arbër Hadrit përfshin një gamë të gjerë veprash, përfshirë monografi shkencore, vëllime dokumentare, punime akademike, kumtesa dhe udhëheqje projektesh të rëndësishme kërkimore-shkencore. Huluntimet e tij janë kryesisht të përqendruara në historinë e Kosovës dhe shqiptarëve nga viti 1912 deri në 2008. Përmes studimeve historike, Hadri ka kontribuar në ndriçimin historiografik të qëndrimit të politikave të jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Fuqive të tjera të Mëdha lidhur me çështjen shqiptare dhe Kosovën gjatë shekullit XX, deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Ai është aktivisht i angazhuar në projekte shkencore të Institutit dhe të institucioneve të tjera shkencore në Kosovë. Ndër angazhimet e tij kryesore janë roli i redaktorit përgjegjës i “Lufta në Kosovë 1998-1999,” pjesë e projektit “Enciklopedia shqiptare” të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe udhëheqja e projektit “Kosova në dokumentet anglo-amerikane dhe shqiptare.” Gjithashtu, ai luan një rol të rëndësishëm si Sekretar Shkencor në bashkërendimin e projekteve kolektive të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë dhe kontribuon në aspektin shkencor në këto projekte dhe nisma të tjera të institucioneve shkencore dhe profesionale në Kosovë.

Ka mbajtur një sërë funksionesh dhe pozicionesh udhëheqëse të rëndësishme profesionale dhe institucionale në Kosovë. Ka shërbyer si drejtor i Muzeut Kombëtar të Kosovës (2001-2012) dhe si mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës. Ishte drejtori i parë i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës dhe ka udhëhequr konceptimin,

themelimin dhe drejtimin e disa institucioneve të rëndësishme kulturore, përfshirë Muzeun Etnologjik të Kosovës (si pjesë e Muzeut të Kosovës), Muzeun “Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës - Dr. Ibrahim Rugova,” Parkun Arkeologjik të Kosovës dhe Muzeun “Isë Boletini.”

Ndër të tjera, ka udhëhequr fushatën për kthimin e koleksionit muzeal të Kosovës dhe të Hyjneshës në Fron, si pjesë e Muzeut të Kosovës. Ka qenë kryeredaktor i revistës shkencore-profesionale "Buletini" të Muzeut të Kosovës dhe ideator i eksponatit muzeor të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, ka qenë anëtar i grupeve punuese për hartimin e ligjeve dhe rregulloreve për trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Aktiviteti kërkimor - shkencor dhe profesional

Bazuar në kërkesat e konkursit për vendin e punës *Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 – zgjedhje; Statutit, Rregulloreve dhe akteve të tjera të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë; si dhe sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht Shtojcës II, pika A, tabela 1.2: Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente në gjuhën shqipe, - të ketë së paku 2 (dy) vepra shkencore monografike dhe vëllime me dokumente të botuara, kandidati Arbër Hadri ka këto monografi dhe dokumente të përmbledhura të publikuara:*

Tabela nr. 1: Monografi studimore dhe libra me dokumente					
<i>Nr.</i>	<i>Autori/autorët</i>	<i>Titulli</i>	<i>Lloji i botimit</i>	<i>Botuesi</i>	<i>Vendi dhe viti</i>
1.	Arbër Hadri	Presidenti Villson dhe çështja Shqiptare: Politika e SHBA në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920	Libër monografik	Instituti i Historisë “Ali Hadri”	Prishtinë, 2012. ISBN 978-9951-210-00-3
2.	Arbër Hadri	Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA: Lufta në Kosovë 1998 - 1999	Libër monografik	SHBAAH – QK	Prishtinë, 2020. ISBN 978-9951-409-33-9

3.	Arbër Hadri	Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës 1989-2008	Libër monografik	Instituti i Historisë "Ali Hadri"	Prishtinë, 2024. ISBN 978-9951-392-17-4
4.	Marenglen Verli, Arbër Hadri & Ibrahim Gashi.	Shqipëria në Dokumentet Amerikane Janar - Maj: 1945 I Albanian in United States documents : 1945 January - May	Vëllime me dokumente	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Tiranë, 2024 ISBN 978-9928-809-24-7
5.	Arbër Hadri & Armend Mehmeti	Marrëdhënie Jozyrtare: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Qeveria Revolucionare në Shqipëri - 1924 - Informal Relations: United States and the Revolutionary Government in Albania	Vëllime me dokumente	Instituti i Historisë "Ali Hadri"	Prishtinë, 2024. ISBN 978-9951-392-02-0
6.	Arbër Hadri	Dokumente shtetërore - publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA : Kosova -	Vëllime me dokumente	SHBAAH	Prishtinë, 2024 ISBN 978-9951-21-003-4

		1 tetor 1998 - 24 mars 1998 – II			
7.	Arbër Hadri	Dokumente shtetërore-publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA : Kosova - 19 qershor 1998 - 31 tetor 1998 – I	Vëllime me dokumente	SHBAAH	Prishtinë, 2020 ISBN 978-9951-210-02-7

Në shtyp:

8.	Arbër Hadri Marenglen Verli	Shqipëria në Dokumentet Amerikane 1945 II Albania in United States documents	Vëllime me dokumente	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Tiranë
9.	Marenglen Verli Arbër Hadri	Kosova në vitet 80' sipas AXhANSE-ve të ATSh	Vëllime me dokumente	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Tiranë

Bazuar në kërkesat e konkursit; *Statutit, Rregulloreve dhe akteve të tjera të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë*; duke e përfshirë nenin 33 pika 2 të Ligjit nr. 04/L-135 për *Veprimtari Kërkimore-Shkencore* (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013); si dhe nenin 5, pika 1.3.1 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve* të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – **që ka botuar së paku pesë (5) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë - Shtojca I, pika A respektivisht A. 2.1, punimet e publikuara në revista ndërkombëtare të cilat janë të indeksuara në platformat akademike me 1 dhe pika A. 2.2, punimet e publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlershme me 1, si dhe nenin 4 - fusnotat përkatëse 1 & 2 të rregullores në fjalë**, kandidati Arbër Hadri ka këto punime të publikuara:

Tabela nr. 2: Punime shkencore ndërkombëtare dhe shkencore sipas dispozitave						
<i>Nr.</i>	<i>Emri dhe mbiemri</i>	<i>Titulli i punimit</i>	<i>Revista / Botimi</i>	<i>Vëll. (viti)</i>	<i>Nr.</i>	<i>Linku publikimit</i>
1.	Arbër Hadri	Ultimatumi i Presidentit Bill Clinton dhe Përgatitjet për Intervenimin Ushtarak në Kosovë, Shtator-Tetor 1998.	<i>Kosova</i>	Nr. (2020), 2023);	47	https://doi.org/10.62609/ks.v47i47.3701
2.	Arbër Hadri	Relacione të Departamentit të Shtetit të SHBA, Lidhur me Spastrimin Etnik të Popullit Shqiptar dhe Krimet Serbe Kundër Njerëzimit në Kosovë (1999).	<i>Gjenocidi dhe Masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999)</i>	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,		https://ashak.org/botime/genocide-and-massacres-of-serbia-in-kosova-1998-1999/
3.	Arbër Hadri	Genocide Halt And Reconstructing Kosovo: President Clinton's Policy	<i>Democracy, Human Rights, and Peace Building Service</i>	<i>University of Arkansas - Clinton School of Public</i>		https://clinton-school.uasys.edu/events/conference-in-conjunction-with-25th-anniversary-of-nato-intervention-in-kosovo/
4.	Arbër Hadri	Kosovo State Building: United States Policy	<i>Unfinished Statebuilding and Contested Democracies (EEGA)</i>	<i>University of Leipzig - Leibniz Science „Eastern Europe –</i>		https://www.leibniz-eeega.de/wp-content/uploads/2024/08/EEGA_Annual-Conference-

				Global Area“ Reflections on the Kosovo War: 25 Years Later” - 2024.	2024_programme.pdf
5.	Arbër Hadri	U.S. Congressional Engagement with American Foreign Policy on the Kosovo Question, 1986–1996	<i>Balkan Journal of Interdisciplinary Research,</i>	Vol. 4, no. 1, May 18. Austria, IIPCCL	https://iipccl.org/wp-content/uploads/2018/05/BJIR-May-20181.pdf ;
6.	Arbër Hadri	"The Kumanovo Agreement: Establishing the Conditions for Kosovo's Governance"	<i>EJELS Journal Sciendo- De Gruyter</i>	Vol. 9 No. 1-25	https://search.worldcat.org/title/1076403163
7.	Arbër Hadri	US Congressional Voice: Resolutions On The Suppression Of Kosovo's Self-Governance And Human Rights, 1986-1989”	<i>Eminak</i>	N. 4 - 48	https://www.eminak.net.ua/index.php/eminak
8.	Arbër Hadri	The Kosovo Self-Defense Act of 1999 - Policy Proposal and Strategic Context	<i>Sciendo- De Gruyter - BJIR</i>	Vol. 9 No. 1 – 25	https://search.worldcat.org/title/1322967949
9.	Arbër Hadri	Politika e SHBA ndaj Formësimit të Shtetit Shqiptar: Nga Konferenca e Londrës deri te Njohja (1912-1922).	<i>Konferenca e Ambasadorëve dhe Shqiptarët</i>	Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë,	https://ashak.org/botime/konferenca-e-ambasadoreve-ne-londer-

				Prishtinë. 2024	dhe- shqiptaret/
10.	Arbër Hadri	Përkrahja e SHBA-së në rimëkëmbjen e Kosovës së pasluftës: Qëndrimi amerikan ndaj çështjes së Kosovës 1999-2004	<i>Gjurmime Albanologjike - Seria e Shkencave Historike</i>	nr. 48, 18	https://search.worldcat.org/title/1039396594
11.	Arbër Hadri	Politika e SHBA ndaj Çështjes Shqiptare në Prag të Konferencës së Paqes në Paris 1919-1920.	<i>Kosova</i>	11, 33-34 / 11	https://search.worldcat.org/title/30148724
12.	Arbër Hadri	Hadri, Arbër. "Çështja Shqiptare dhe Këshilli i të Katërve në Konferencën e Paqes në Paris (Janar-Nëntor 1919).	<i>Kosova</i>	nr. 27 / 05	https://search.worldcat.org/title/30148724
13.	Arbër Hadri	Burimet Historike të SHBA Lidhur me Politikën e Jashtme Amerikane ndaj Çështjes Shqiptare: Pjesa e Parë e Shekullit XX	<i>Gjurmime Albanologjike - Seria e Shkencave Historike</i>	nr. 48 / 18	https://search.worldcat.org/title/1039396594
14.	Arbër Hadri	Historiografia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Lidhur me çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920.	<i>Vjetar</i>	Nr. 39-40 /08 Arkivi i Kosovës.	https://search.worldcat.org/title/965145923
15.	Arbër Hadri	Periodizimi i qëndrimit të Shteteve të	<i>Kosova 49 - 24</i>		https://ih-rks.org/

		Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës			
16.	Arbër Hadri <i>Coauth</i>	From destruction to urban reconstruction of Mitrovica: A case study after the war in Kosovo	<i>Historijski Pogledi</i>	nr.13-25 në botim.	https://search.worldcat.org/title/115455856 1
17.	Arbër Hadri <i>Coauth</i>	The humanitarian crisis in Albania in 1924: American efforts to relieve the social conditions of the population in the north	<i>Shejzat</i>	1-2/25 në botim.	https://search.worldcat.org/title/112483958 2

Punime të tjera shkencore dhe në botim:

• “INQUIRY ON BALKANS: ALBANIA IN UNITED STATES PREPARATIONS FOR PEACE CONFERENCE”.
• “PRESIDENT WILSON’S STANCE ON ALBANIA AT THE PARIS PEACE CONFERENCE”.
• “US POLICY ON ALBANIA AND ADRIATIC QUESTION AT CONFERENCE OF AMBASSADORS IN PARIS”.
• “HISTORIOGRAFIA E SHBA-SË LIDHUR ME PRESIDENTIN VILSON DHE ÇËSHTJEN SHQIPTARE NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS 1919-1920”
• “INFORMAL RELATIONS: THE UNITED STATES AND THE REVOLUTIONARY GOVERNMENT IN ALBANIA - 1924”.
• “FOREIGN RELATIONS BETWEEN THE UNITED STATES AND ALBANIA 1939–1944”.
• “MISSION IMPOSSIBLE: US EFFORTS TO RESTORE ESTABLISHMENT OF DIPLOMATIC RELATIONS WITH ALBANIA 1945 – 1946”

• “FROM OBSERVATIONAL POLICY TO RED LINE WARNING: US FOREIGN POLICY TOWARD KOSOVO AT THE END OF THE COLD WAR”
• “RECONSTRUCTING KOSOVO: A US CONTRIBUTION”.
• “ÇËSHËTJA SHQIPTARE DHE KËSHILLI I TË KATËRVE NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS (JANAR-NËNTOR 1919)”
• “THE EMERGING US-ALBANIAN RELATIONS AND KOSOVO ISSUE”
• “LINKING KOSOVO AND BOSNIA WARS: US STANCE”
• “US CONGRESSIONAL RESOLUTIONS ON PREVENTING WAR ESCALATION IN 1998”
• “KOSOVO WAR: NSC STANCE 1998”
• “KOSOVO IN THE SITUATION ROOM 1999”
• “CONGRESS PROSPECT OF U.S. PARTICIPATION IN PEACEKEEPING: RAMBOUILLET ACCORDS”
• “OPERATION ALLIED FORCE AND THE ROLE OF CONGRESS”
• “PREPARING FOR A GROUND INVASION: CONGRESS PERSPECTIVE”
• RESOURCES AND BURDEN-SHARING IN POST-CONFLICT KOSOVO: US PERSPECTIVE

Bazuar në kërkesat e Konkursit; Statutit, Rregulloreve dhe akteve të tjera të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë; si dhe duke e përfshirë Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika B, tabela 1.2: Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor; pika C, tabela 1.1: Prezantime gojore-shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete** (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit - **Të ketë pjesëmarrje në konferenca shkencore së paku në tri (3), nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare**, kandidati Arbër Hadri ka marr pjesë në këto Konferenca:

Tabela nr. 3: Konferencat shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, simpoziumet, tryezat shkencore dhe aktivitete të tjera shkencore e profesionale

Autori; Titulli i punimit; Konferenca; Botuesi dhe vendi; Vëllimi, nr., viti.

1. Hadri, Arbër. SHKAQET DHE PASOJAT E LUFTËRAVE BALLKANIKE NË RAPORTIN E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR "CARNEGIE": VËSHTRIM MBI TREVAT SHQIPTARE", "ÇËSHTJA SHQIPTARE NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE NË LONDËR (1912-1913)" /Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë & Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik - Departamenti i Historisë, 26 tetor 2023.

2. Hadri, Arbër. "ROLI I GRUAS SHQIPTARE NË ORGANIZATAT E FSHEHTA POLITIKE NË KOSOVË", organizuar nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe Iniciativa për Histori Gojore.

3. Hadri, Arbër. "QËNDRIMI I POLITIKËS AMERIKANE NDAJ LUFTËS NË KOSOVË 1997-1999", "Kosova 1989-1999: organizimi dhe qëndresa për çlirim". Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë.

4. Hadri, Arbër. "REPRESIONI SHTETEROR JUGOSLLAV NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS 1945-1966", "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX", Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Prishtine, 2022.

5. Hadri, Arbër. "KOSOVA PAS BUJANIT: PËRBALLË RENDIT TË RI BOTËTOR DHE KRIJIMIT TË JUGOSLLAVISË FEDERATIVE", "Konferenca: Roli i Konferencës së Bujanit në procesin e shtetformimit të Kosovës". Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.

6. Hadri, Arbër. "DIMENSIONI HISTORIK I RRUGËS SË KOMBIT", Java e Albanologjisë - edicioni i 13, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2022.

7. Hadri, Arbër. "Relacione të Departamentit të Shtetit të SHBA, Lidhur me Spastrimin Etnik të Popullit Shqiptar dhe Krimet Serbe Kundër Njerëzimit në Kosovë (1999)." Në *Gjenocidi dhe Masakrat e Serbisë në Kosovë*, 28 prill 2023. ASHAK – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.

8. Hadri, Arbër. "Qëndrimi i SHBA-së ndaj Sigurisë Kombëtare të Kosovës: Nga Lufta deri te Shtetndërtimi." Në *Kosova 15 Vjet Pavarësi - Sfidat dhe Shtetndërtimi*, 17 shkurt 2023. Instituti i Historisë "Ali Hadri," Prishtinë.

9. Hadri, Arbër. "Roli i Sekretareve të Shtetit Amerikan në Lirinë, Pavarësinë dhe Shtetndërtimin e Kosovës." I Në <i>Roli i Grave në Jetësimin e Shtetit të Kosovës: Aspekte Sociale, Kulture, Politike nga viti 1980 dhe deri në ditët e sotme</i> , 5 maj 2023. Instituti i Historisë "Ali Hadri" - ASA, Tiranë, Prishtinë.
10. Hadri, Arbër. "25th anniversary of NATO intervention in Kosovo: Democracy, human rights, and peace building", Clinton School of Public Service, 2024.
11. Hadri, Arbër. "Bondsteel: Përkrahja e SHBA në Rimëkëmbjen e Kosovës dhe Ferizajit." Në <i>Ferizaj në rrjedhat e historisë</i> , 10 qershor 2023. Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë & Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina," Fakulteti Filozofik - Departamenti i Historisë, Prishtinë.
12. Hadri, Arbër. "Politika e SHBA ndaj Formësimit të Shtetit Shqiptar: Nga Konferenca e Londrës deri te Njohja (1912-1922)." Në <i>Konferenca e Ambasadorëve dhe Shqiptarët</i> , 13 tetor 2023. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë.
13. Hadri, Arbër. "Konferenca e Bujanit dhe Krijimi i Entitetit Politik të Kosovës." Në <i>Konferenca e Bujanit: Retrospektiva dhe Rezultatet Historike</i> , 8 dhjetor 2023. Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë.
14. Hadri, Arbër. "Shkaqet dhe Pasojat e Luftërave Ballkanike në Raportin e Komisionit Ndërkombëtar 'Carnegie': Vështrim mbi Trevat Shqiptare." Në <i>Çështja Shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)</i> , 26 tetor 2023. Instituti i Historisë "Ali Hadri" & Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina," Fakulteti Filozofik - Departamenti i Historisë", Prishtinë.
15. Hadri, Arbër. "REFLECTIONS ON THE KOSOVO WAR: 25 YEARS LATER", "Unfinished Statebuilding and Contested Democracies", Dubrovnik, 2024.
16. Hadri, Arbër. "Kosova 15 vjet pavarësi – sfidat dhe shtetndërtimi", Sesion Shkencor mbajtur më 15 shkurt 2023 në Prishtinë, Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë në organizim të përbashkët me Institutin Albanologjik në Prishtinë, Institutin e Historisë në Tiranë, Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulture të Shqiptarëve - Shkup dhe Departamentin e Historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë.
17. Hadri, Arbër. "Konferenca shkencore ndërkombëtare - Java e Albanologjisë-edicioni i 13", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2022.

18. Hadri, Arbër. Konferenca shkencore regjionale për 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë - “Roli i SHBA-ve në Shtetformimin e Shqiptarëve”, UBT dhe “Miqë e Amerikës”, 20 nëntor 2012, Prishtinë.
19. Hadri, Arbër. “A Scientific Approach to History and Cultural Heritage in South-Eastern Europe”, TUBA – Turkish Academy of Sciences, Istanbul, 8 dhjetor 2005.
20. Hadri, Arbër. “Cultural Heritage in Kosovo: From Apple of Discord to Ferment of Reconciliation”, 14 nëntor 2006, UNESCO Headquarters, Paris.
21. Hadri, Arbër. “Civil Dialogue - precursor of good neighborly relations”, The Helsinki Committee for Human Rights and the Kosovo Foundation for Open Society, 14-15 tetor, 2010, Prishtinë.
22. Hadri, Arbër. “Kultura në komunikimet ndërshqiptare dhe prezentimi i saj në botë”, 12 tetor 2010, Gjirokastër.

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, përkatësisht **Shtojcës II, pika C, tabela 1.2: Kryeredaktor, redaktor shkencor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje:**

Tabela nr. 4: Kryeredaktor, redaktor shkencor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje:				
<i>Nr.</i>	<i>Kontributi (redaktor, recensues...)</i>	<i>Autori original i librit</i>	<i>Titulli i librit</i>	<i>Vendi dhe viti</i>
1.	Arbër Hadri Redaktor shkencor	Ali Hadri	<i>Studime dhe Kritikë Historiografike</i>	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2023
2.	Arbër Hadri Recensues	Miftar Kurti	<i>NATO për Kosovën</i>	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2024

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht Shtojcës II, pika C, tabela 1.4: *Kontribute tjera profesionale-shkencore:*

Tabela nr. 5: Kontribute tjera profesionale-shkencore:			
<i>Nr.</i>	<i>Autori/autorët</i>	<i>Lloji i kontributit shkencor</i>	<i>Vendi dhe viti</i>
3.	Arbër Hadri	Sekretar shkencor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”	Nëntor 2024 – në vazhdim.
2.	Arbër Hadri	Anëtar i këshillit organizativ të: Konferencës shkencore: “Konferenca e Bujanit: Retrospektiva dhe Rezultatet Historike.	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë. 8 dhjetor 2023
4.	Arbër Hadri	Recensent i disa punimeve të dorëzuara për botim në kuadër të punimeve të konferencave shkencore.	2023-2024

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, përkatësisht Shtojcës II, pika D, tabela 1.1: *Pjesëmarrje e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore:*

Tabela nr. 6: Pjesëmarrje e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore:				
<i>Nr.</i>	<i>Programi/projekti shkencor</i>	<i>Periudha kohore</i>	<i>Pozicioni në projekt</i>	<i>Institucioni dhe vendi</i>
1.	“ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE” <i>Lufta në Kosovë 1998-1999.</i> Projekt afatgjatë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2023 - në vazhdim.	2023 – në vazhdim	Redaktor përgjegjës	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

2.	“Kosova në dokumentet anglo-amerikane dhe shqiptare 1989-1997”.	2024	Udhëheqës i projektit	MASHTI
3.	Historia e Kosovës	2023 - në vazhdim	Pjesëmarrës në projekt - për tekstin “Marrëdhënie shqiptaro-amerikane”.	Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë
4.	Projektet kolektive shkencore të Institutit	Nëntor 2024 – në vazhdim	Sekretar Shkencor i Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, nëntor 2024 - në vazhdim. Bashkërendon projektet shkencore redaktoriale në cilësinë e redaktorit shkencor - Sekretarit shkencor	Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë
5.	Harta Arkeologjike e Kosovës	2002 – 2012	Mbikqyrës i projektit në cilësinë e Drejtorit	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Muzeu i Kosovës, Instituti Arkeologjik i Shqipërisë
6.	Shqipëria në dokumentet amerikane 1945 – 1948	2023 - në vazhdim	Autor - Redaktor	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
7.	Kosova në vitet 80’ sipas AXhANSE-ve të ATSh	2024 – në vazhdim	Autor - Redaktor	Akademia e Shkencave e Shqipërisë

KONKLUZION

Bazuar në konkursin e shpallur nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, të publikuar gazetën “Epoka e Re” e datës 28 nëntor 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurse/Konkurs-Instituti-i-Historise-28-11-2024.pdf>, për vendin e punës *Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 - zgjedhje*, si dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve dhe rregulloreve e akteve të tjera përkatëse të Institutit*, si dhe bazuar në vendimin e datës 27.11.2024 të Këshilli Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Fehmi Rexhepi - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha – anëtare, dhe prof. dr. Teuta Shala - Peli, ka arritur në këtë konkluzion:

Kandidati Arbër Hadri ka paraqitur dëshmi të (7) monografive dhe përmbledhjeve me dokumente nga fusha dhe nga periudha përkatëse e studimit - të paraqitura në tabelën e parë, të cilat kanë vlerësim të lartë të miratuar si vepra historike me rëndësi për historiografinë e Kosovës. Më shumë se (5) punime shkencore të indeksuara në platforma relevante ndërkombëtare apo kombëtare në pajtim me nenin 33 pika 2 të *Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit*, nenit 4 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve; si dhe Statutit, rregulloreve dhe akteve të tjera të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë*, të paraqitura në tabelën e dytë.

Dëshmitë e parashtruara argumentojnë pjesëmarrjen e kandidatit Arbër Hadri në më shumë se (20) Konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, simpoziume, tryeza shkencore dhe aktivitete të tjera shkencore e profesionale - të përshkruara më lartë, duke u përfshirë edhe në projekte shkencore individuale dhe kolektive, brenda fushës së përcaktuar.

Kandidati Arbër Hadri ka dëshmuar nivel të lartë kompetence dhe përvojë shkencore për periudhën historike përkatëse. Ai gjithashtu ka treguar aftësi të spikatura për udhëheqjen e projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike - të përshkruara më lartë në formë tabelare, përmes përvojës së tij në realizimin e shumë projekteve të udhëhequra nga institucione shkencore dhe akademike.

Kandidati Arbër Hadri ka drejtuar dhe vazhdon të drejtoj projekte profesionale-shkencore në kuadër të institucioneve shkencore dhe akademike në Kosovë e Shqipëri, si dhe ka drejtuar institucione të rëndësishme kombëtare si drejtor i Muzeut Kombëtar të Kosovës, Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës dhe ka udhëhequr konceptimin, themelimin dhe drejtimin e disa institucioneve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore – historike dhe ideator i eksponatit muzeor të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.


Duke marr parasysh argumentet e cekura më lartë, përgatitjen adekuate për periudhën e caktuar, si dhe plotësimin e të gjitha kushteve të konkursit, Komisioni recensues ka ardhur në përfundim se kandidati Arbër Hadri ka të arritura dhe kontribute shkencore të profilizura për periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, si dhe meritokracinë profesionale-shkencore të veçantë, që i mundësojnë zgjedhjen sipas pozitës së kërkuar në konkurs - Këshilltar Shkencor, respektivisht i ka plotësuar gjitha kushtet e parapara me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër Komisioni recensues ka nderin të parashtoj këtë:

PROPOZIM

Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Fehmi Rexhepi - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha - anëtare dhe prof. dr. Teuta Shala - Peli - anëtare, bazuar në kriteret dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në këtë konkurs, si dhe në të arriturat e paraqitura në konkluzion dhe të dokumentuara më lartë, për vendin e punës *Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 - zgjedhje*, i propozon Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, kandidatin dr. Arbër Hadri.

Komisioni recensues:

Prof. dr. Fehmi Rexhepi - kryetar



Prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha - anëtare



Prof. dr. Teuta Shala - Peli - anëtare

